

TERMAT E REFERENCËS

Pozicioni: Ekspert i Shëndetit Mendor për Studimin Bazë dhe Kontributet Politike

Institucioni përfitues: Agjencia Kombëtare e Rinisë (PP02), Shqipëri

Emri i projektit: HARMONY — “Health and Resilience: Mental Empowerment for New Youth”

Kodi i projektit: 03C1055

Programi i financimit: Interreg Europe

Instrumenti i politikës i adresuar: Strategjia Kombëtare e Rinisë 2022–2029

Data e përfundimit të kontratës: Prill 2028 (ose me finalizimin e të gjithë produkteve)

Vendi i angazhimit: Tiranë / me mundësi angazhimi online dhe pjesëmarrje në evente

Raportimi: Te Koordinatorin e Projektit të HARMONY pranë AKR-së

1. Konteksti i projektit

Projekti **HARMONY**, i financuar nga Interreg Europe, synon përmirësimin e politikave rajonale që mbështesin shëndetin mendor të të rinjve në Europë. Ai fokusohet në ndërveprim të strukturuar politikash, shkëmbim praktikash dhe rritje të kapaciteteve institucionale.

Agjencia Kombëtare e Rinisë (AKR), si partneri i projektit për Shqipërinë (PP02), është përgjegjëse për realizimin e aktiviteteve kombëtare dhe kontributit politik në komponentët e projektit. Në këtë kuadër, kërkohet angazhimi i një **eksperti të jashtëm të shëndetit mendor**, i specializuar në kërkime, sduime dhe vlerësime të shëndetit mendor të të rinjve, për të mbështetur AKR në përgatitjen e një studimi paraprak për të parë gjendjen e shëndetit mendor dhe formulimin e rekomandimeve për politika sektoriale dhe ndërsektoriale në mbështetje të përmirësimit të kuadrit politik dhe ligjor për shëndetin mendor.

2. Qëllimi i pozicionit

Eksperti do të mbështesë AKR në:

- përgatitjen e një studimi bazë mbi shëndetin mendor të të rinjve në Shqipëri (eksperti do të jetë përgjegjës për hartimin e instrumentave, mbledhjen, analizën e të dhënave dhe hartimin e raportit)
- ofrimin e kontributeve teknike/ analitike në dokumentet politike të projektit;
- pjesëmarrjen profesionale në një takim kombëtar me aktorë të ndryshëm;
- kontributin tematik në një shkëmbim ndërrajonal të projektit;
- përgatitjen e një raporti final konsulence me rekomandime të zbatueshme për politikat publike.

Pozicioni është thelbësor për garantimin e perspektivës shkencore dhe të bazuar në evidencë në proceset e përmirësimit të politikave rinore në fushën e shëndetit mendor.

3. Detyrat dhe përgjegjësitë

Eksperti, për 25 ditë pune - do të kryejë këto detyra kryesore:

A. Studimi Bazë mbi Shëndetin Mendor të të Rinjve në Shqipëri

- Hartimi i protokollit dhe instrumentave të vlerësimit
- Mbledhja e të dhënave përfshirë rishikim të dokumentave dhe intervista me aktorë kyç (institucione, organizata, etj).
- Analiza e të dhënave dhe hartëzimi i mangësive institucionale dhe shërbimeve ekzistuese.
- Hartimi i raportit dhe diskutimi me AKR dhe aktorë të rëndësishëm
- Dorëzimi i raportit të studimit bazë.

B. Kontribut në konsultimin kombëtar

- Mbështetje për organizimin e një eventit konsultues kombëtar.
- Paraqitja e gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve për ndërhyrje teknike.
- Dokumentimi dhe përfshirja në raportin përfundimtar të feedback-ut të pjesëmarrësve.

C. Pjesëmarrje në një shkëmbim ndërrajonal

- Kontribut profesional në një aktivitet ndërrajonal (online ose fizik).
- Përgatitja e përmbledhjeve analitike për raportet ndërrajonale të NYA.
- Paraqitja e sfidave prioritare të Shqipërisë në fushën e shëndetit mendor të të rinjve.

D. Raport final konsulence

- Hartimi i **Raportit Final të Ekspertit**, me rekomandime praktike për integrimin e shëndetit mendor në politikat lokale/rajonale.
- Përmbledhja e mësimave të nxjerra dhe rekomandimeve të zbatueshme.

4. Kualifikime të kërkuara

Kandidati duhet të plotësojë këto kërkesa:

Arsimi:

- Diplomë universitare minimumi Master në psikologji ose në fusha të ngjashme.

Përvoja profesionale:

- Të paktën 3 vite përvojë në hartime dhe zbatimë studimesh
- Të paktën 3 vite përvojë relevante profesionale në këshillim psikosocial ose shërbime të shëndetit mendor.
- Përvojë në ofrimin e trajnimeve të mbështetjes së shëndetit mendor, në mënyrë të preferueshme për të rinj ose grupe vulnerabël.
- Njohje me përdorimin e mjeteve kreative ose metodave të lehtësimit që nxisin besimin dhe komunikimin në kontekste ndërkulturore ose me shumë palë të interesit.

- Përfshirje e mëparshme në evente trajnimi virtuale ose webinarë (minimumi 5 evente të zhvilluara).
- Angazhimi paraprak në kërkime bazë, raporte vlerësimi ose studime tematike mbi përfshirjen sociale, shëndetin mendor ose zhvillimin e të rinjve konsiderohet një avantazh.
- Përvoja në projekte të financuara nga BE ose donatorë do të vlerësohet pozitivisht.

Aftësitë:

- Aftësi e provuar për të prodhuar raporte analitike të qarta, koncize dhe të bazuara në evidenca.
- Njohje e plotë e anglishtes dhe shqipes, me shkrim dhe me gojë.
- Aftësi të forta komunikimi dhe prezantimi, përfshirë lehtësimin online.
- Nivel i lartë autonomie dhe besueshmërie, me aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur dhe për të respektuar afatet.

Të gjithë ekspertët duhet të jenë të pavarur dhe të lirë nga çdo konflikt interesi në detyrat e tyre sipas kësaj kontrate.

Mjediset mbështetëse & backstopping

Kostot për mjediset mbështetëse, përfshirë backstopping-un, janë të përfshira në ofertën financiare të ofertuesit.

Akomodimi i zyrës

Nuk do të ofrohet hapësirë zyre nga autoriteti kontraktues. Eksperti pritët të punojë nga ambientet e tij.

Mjediset që do të sigurohen nga kontraktori

Eksperti duhet të sigurojë akses në:

- Infrastrukturë të sigurt dhe të besueshme digjitale për përpunimin e të dhënave dhe komunikimin;
- Softwer për produktivitet për shkrimin e dokumenteve dhe paraqitjen e të dhënave (p.sh., Word, Excel, mjete PDF);
- Mjete komunikimi si email, platforma videokonferencash dhe sisteme për dokumente të përbashkëta.

Të gjitha mjetet dhe kostot për zbatimin mbulohen nga kontraktori dhe janë të përfshira në çmimin global.

Pajisjet

Nuk do të blihet pajisje nën këtë kontratë. Çdo mjet, pajisje ose softuer i përdorur për realizimin e detyrës duhet të sigurohet dhe mirëmbajtë nga kontraktori.

5. Kohëzgjatja dhe vendndodhja

- Fillimi i zbatimit: **Janar 2026**
- Kohëzgjatja totale: **25 ditë pune**, të përdorura nga Janar 2025 – Prill 2028
- Vendi kryesor: **Tiranë**, me mundësi pune në distancë
- Pjesëmarrja fizike kërkohet për:
 - 1 takim kombëtar të aktorëve;
 - 1 aktivitet ndërrajonal (fizik ose online, sipas planit të projektit).

6. Dokumentet që duhet të dorëzohen

Kandidati duhet të dorëzojë:

- **CV të përditësuar**
- **Letër motivimi**
- **Kopje të diplomave**
- **Dokumente që vërtetojnë eksperiencën profesionale (links të dokumentave të punuar)**
- **2 Referenca profesionale**

7. Mënyra e aplikimit dhe afati

Aplikimet duhet të dërgohen në adresën zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Rinisë:

 info@akr.gov.al

Afati i fundit për dorëzimin e aplikimeve është **03 Janar 2026**.